

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit D. M nga Gj, për shkak të veprës penale posedim I paautorizuar I narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 275 parag.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1582/16, e datës 27.09.2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 06.04.2017, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri **D.M**, nga babai R dhe nëna R, e lindur H, i lindur më.., në Gjilan, me vendbanim në Gj, i martuar,e ka te kryer shkollen e mesme, puntor krahu-i paunë, i gjendjes së varfer ekonomike,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me, nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë vepër tjetër penale,

Është fajtor

Me datë 18.08.2016, në rrugën "... "në Gj, i pandehuri D. M.pa leje dhe autorizim ka poseduar substanca narkotike, në at mënyrë që pasi që është ndalua dhe kontrolluar nga Njësi të Hetimit të Narkotikëve në Gjilan, në xhepin e pantallonave, i është gjetur substanca narkotike e llojit "... " prej ...E mbështjellur me letër folije, kështu që i pandehuri me veprimet e veta pa leje dhe autorizim ka poseduar substanca narkotike.

- me këtë ka kryer vepër penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21,41,42,46 ,69 e 73 të KPRK, si dhe nenit 365 e 451 të KPP, të pandehurit i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit D. M, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) Eurove, të cilën dënim ai duhet ta paguajë nëse në afatin prej 15 (pesmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, e nëse ai ate nuk e paguan, dënimi i shqiptuar me gjobë do ti shëndrrohet në dënim me burgim ku 20 Euro do ti barazohen me një ditë burgimi.

Poashtu atij do ti shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës se gjetur narkotike.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit D.M, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 parag.2 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Shefik Mehmeti në fjalën e tij përfundimtare deklaron:mbes në tersi pran aktik akuzues pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësin për veprën penale e cila i vihet në barrë, për të cilën pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimi të tij.Mbi bazën e këtij pranimi dhe provat të tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj me dënim meritore sipas ligjit i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësis penale dhe rrezikshmëris shoqërore të kësaj vepre penale.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjykata, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit dhe të konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 parag.2 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të pandehurin, nga Gj, për shkak të veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi dënimin plotësues është i bazuar në nenin 62 e 69 të KPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 06.04.2017

**Zyrtarja ligjore, ,
Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*